



In medias res

Fazat nëpër të cilat kalojnë ndryshimet në arsim KONSENSUALITETI

“Ç’ mund të ishte me e keqe se sa verbëria e trashëguar?... Të kesh sy e të mos kesh vizion?”

Hellen Keller

Ndryshimet në arsim janë komplekse dhe shumë të vështira, sepse në to marrin pjesë shumë njerëz me interesa dhe nevoja të ndryshme. Harmonizimi i këtyre nevojave është një çështje e cila kërkon shumë kohe dhe shumë debate. Ato pra duhet të jenë konsensuale, sepse nëse ato nuk i shprehin interesat e shumicës absolute të qytetarëve ato jo vetëm që nuk do të arrijnë të realizohen, por do të jenë në funksion të krijimit të konflikteve dhe të dallimeve sociale të cilat gjenerojnë kriza të reja dhe konflikte të ndryshme sociale, ekonomike, etnike etj.

Por harmonizimi dhe përfshirja e të gjitha interesave kërkon, siç është potencuar edhe në shkrimet e më hershme, që ndryshimet të bëhen mbi një revizion apo vlerësim të gjendjes së shëndetit të arsimit, përkatësisht të identifikimit të pikave të forta, pikave të dobëta, të mundësive për realizimin dhe zbatim të suksesshëm të ndryshimeve. Me revizion përcaktohet shëndeti i arsimit.

Teoria e ndryshimeve siç është potencuar në shkrimet e deritashme, sot ofron një spektër të gjerë të metodologjive për konstatimin, diagnostifikimin e gjendjes shëndetësore të sistemit të arsimit (SWOT analiza, vlerësime të shpejta, vlerësime transversale ose longitudinale). Me këto skanime konstatohen ligjet dhe ligjshmëritë të cilat duhet respektuar në procesin e ndryshimeve, si dhe masat dhe veprimet preventive, terapeutike dhe anticipative dhe avancuese që duhet ndërmarrë.

Shoqëritë anticipative dhe të avancuara që synojnë mirëqenien e qytetarëve të vetë nëpërmjet rritjes së Indeksit të Zhvillimit Njerëzor dhe të Kapitalit Social, si dhe të krijimit të një shoqërie e cila nxënë gjatë gjithë jetës, përkatësisht të një shoqërie e cila zhvillimin e vetë të përgjithshëm e mbështet në një ekonomi të shëndosh të bazuar në prodhimin dhe përhapjen e dijeve dhe të risive, rezultat e vlerësimeve apo të revizioneve pasqyrohen botimin në botimin e një libërthi që jo rrallë quhet *Libër i gjelbër (një metaforë e fuqishme e cila hap dritën për ndryshime pozitive në arsim)*.

Libri i gjelbër shndërrohet në një objekt të debateve të fuqishme në shoqëri, në medime pamore (TV), në radio, revista shkencore dhe profesionale, në gazeta të përditshme, në organe dhe forume të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare. Ky debat ka për qëllim vetëdijësimin e qytetarëve për ndryshime, rritjen e kritikës konstruktive shoqërore ndaj teorisë dhe praktikës arsimore, si dhe krijimin një “presioni” publik mbi hartuesit e politikave i cili ka për synim rritjen e përgjegjësisë publike dhe të llogaridhënës të bartësve të politikave zhvillimore.

Vendet në të cilat ndryshimet në arsim bëhen në mungesë të këtij “presioni” publik nuk arrijnë dot të bëjnë ndryshime pozitive në arsim të cilat do jenë levë e fuqishme e ndryshimeve të përgjithshme në shoqëri. Debati për gjendjen e konstatuar në arsim ka për qëllim që të krijon edhe një “mendësie të re” apo një “metania” siç thotë P. Senge. Studimet tregojnë se: “Sa do që ndryshimet në arsim të jenë të sofistikuara atë në mjediset konservative (në mjedis pa një mendësi të re) nuk arrijnë të jetësohen dot”. Skanimin i gjendjes reale të sistemit të arsimit paraqet fazën e parë të ndryshimit. Me arritjen e konsensusit nacional, krijohen kushte për kalim në fazën e dytë, përkatësisht në fazën e projektimit. Këtë temë do e trajtojmë në vazhdim

Shkroi: Halim Hyseni

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 4-5 prill 2009 është mbajtur seminari i gjashtë me titull “Krijimi i lexuesve mendimtarë” për 7 grupe të mësimit të mesëm që janë duke u trajnuar në kuadër të Programit të MKLSH. Seminari është mbajtur për mësimit të mesëm të Prishtinës (dy grupe), Pejës, Ferizajit, Gjilanit, Gjakovës dhe Mitrovicës. Gjatë këtij seminari, trajnerët kanë paraqitur teknikat dhe strategjitë e modulit 7 & 8 të Programit të MKLSH. Një befasi të këndshme për pjesëmarrës ka shkaktuar paraqitja e teknikës “Pyetje drejtuar autorit”, meqenëse gjatë realizimit të saj u përdor një insert i një programi dokumentar televiziv. Një interesim i madh i mësimit të mesëm u tregua dhe për teknikat e tjera si: RAFT, Seminari i leximit, Imagjinata e drejtuar etj. Pas përfundimit të seminarit të gjashtë, është realizuar monitorimi i dytë për të gjithë pjesëmarrësit në trajnim. Nga raportet e monitorimit kuptohet se pjesëmarrësit janë familjarizuar me filozofinë e programit të MKLSH, teknikat dhe strategjitë në kuadër të këtij programi, si dhe mënyrën e zbatimit të teknikave në klasat e tyre. Pengesat që janë paraqitur gjatë monitorimit të parë si: kufizimi në një numër të teknikave, mungesa e kohës për të realizuar teknikat, si dhe numri i nxënësve në klasë u tejkaluan me sukses gjatë monitorimit të dytë. Të gjitha orët e monitoruara u analizuan gjatë takimeve gjysmë-ditore që janë mbajtur më 25 prill 2009.

■ Më 4 prill 2009 është mbajtur takimi gjysmë-ditor me 36 mësimit të mesëm të komunës së Gjakovës, të cilët janë duke u trajnuar në bashkëpunim me Qendrën Didaktike në Gjakovë. Gjatë këtij takimi u bë diskutimi i orëve të monitoruara. Më 24-25 prill

është mbajtur seminari i fundit me titull “Planifikimi dhe vlerësimi”.

■ KEC në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe DKA e Prizrenit gjatë muajit prill kanë organizuar 3 seminare dhe realizimin e monitorimit të dytë për 7 grupe të mësimit të mesëm që janë duke u trajnuar në kuadër të Programit “Metodologjitë e reja dhe të nxënësve ndërveprues”. Këtë program trajnimi e kanë vijuar 125 mësimit të mesëm të Prizrenit, 24 të Suharekës dhe 64 mësimit të mesëm të Mitrovicës. Nga skedat e daljes dhe fletë vlerësimet shihet se mësimit të mesëm kanë qenë shumë të kënaqur me përgatitjen e trajnerëve, organizimin e seancave të trajnimit dhe mënyrën e realizimit të monitorimit në klasa. Të gjithë mësimit të mesëm me vet financim kanë vazhduar pjesëmarrjen dhe në seminarin e shtatë për të siguruar certifikimin e plotë në kuadër të Programit të MKLSH. Certifikimi i pjesëmarrësve është planifikuar të bëhet në muajin maj.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Gjatë muajit prill në shtatë rajone të Kosovës janë zhvilluar aktivitetet e ndryshme sociale të nxënësve.



Në këto aktivitet sociale kanë marrë pjesë mbi 130 nxënës të shkollave të ndryshme të Kosovës.



■ Po ashtu, është organizuar një konkurs për nxënësit e arsimit të detyruar në temën “Dashuria mund dhunën”. Në konkurs janë paraqitur mbi 40 nxënës.


■ Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar hartimi i Manualit për punën e komiteteve shkollore dhe të komiteteve rajonale (të cilat do të pilotohen), dhe puna e të cilave do të monitorohet gjatë katër muajve.

Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit tetor janë zhvilluar monitorimet nëpër institucione të ndryshme shkollore dhe parashkollore, të cilat punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi.

KOSOVISION Contest

■ Disa projekte kanë përfunduar punën në fillim të këtij muaji ndërsa të tjera presim të përfundojnë në fillim të muajit maj.



Gjatë tërë muajit të gjitha shkollat fituese janë monitoruar nga menaxherët e projektit dhe nga stafi lokal i projektit, për të shikuar nga afër ecurinë e implementimit të projekteve. Vlerësimet e projektit priten të bëhen në javën e parë të muajit maj. Të gjitha klasat fituese kanë bërë edhe dokumentimin e projekteve me anë të të cilave do të bëhet edhe vlerësimi.



■ Tani janë duke u bërë edhe përgatitjet paraprake për ceremoninë e shpërblimeve për 10 fituesit e projekteve. Ceremonia do të mbahet më 16 maj dhe të ftuar do të jenë rreth 400 pjesëmarrës.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, aktivitetet janë duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit. Përveç në Rajonin e Prizrenit, takimet me drejtorët e shkollave pjesëmarrëse në projekt janë mbajtur. Këtë muaj janë bërë përgatitjet për zhvillimin e një punëtorie për zhvillimin e kornizës së monitorimit për metodologjinë e punës në projekt. Mbledhja e materialeve dhe informacioneve relevante për manual është duke vazhduar edhe më tutje.

Prevention on Peer Violence

■ Dinamika e projektit ka vazhduar në bazë të aktiviteteve të parapara në projekt. Këtë muaj janë bërë përgatitjet për zhvillimin e punëtorive në 10 shkollat pjesëmarrëse të projektit. Në të gjitha këto shkolla janë mbajtur nga 3 punëtori të cilat kanë pasur për qëllim që të sensibilizojnë mësime të mësuesit për mënyrën e parandalimit të dhunës ndaj bashkëmoshatarëve. Të gjitha shkollat kanë pasur numër të madh të pjesëmarrësve. Gati nga secila shkollë pjesëmarrës kanë qenë 70-80% e mësime të mësuesve. Punëtoritë e tilla do të mbahen edhe me nxënësit e këtyre shkollave duke filluar në muajin maj e për të vazhduar edhe në muajin qershor. Këto punëtori me nxënës do të mbahen nga mësime të cilët kanë ndjekur këtë trajnim.

Përgatiti: Petrit Tahiri